

TË DREJTAT NË LETËR

MARS, 2019

Kontratë për punë



TË DREJTAT NË LETËR

MARS, 2019

COPYRIGHT © 2019.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Autori: **Florent Spahija**

Layout and design: **envinion**

PËRMBAJTJA

06 LISTA E SHKURTESAVE

07 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

09 HYRJE

10 RASTET E RAPORTUARA

- 10 Sigurojnë objektet shtetërore por jo edhe të drejtat e tyre
- 12 7 muaj pa pagë
- 12 Trustin e paguan por nuk i figuron askund
- 13 Kërkesa e pagës arsye për largim nga puna
- 14 Vonesa e Gjykatës pasojë për punëtorin e lënduar
- 14 Largim nga puna pas lëndimit
- 14 Pushimi i detyruar pa pagesë
- 15 Mos lejim i ndryshimit të vendit të punës
- 15 Reduktim orësh për interesa personale
- 15 Kërcënim në vendin e punës
- 16 Mos avancim në punë pa arsye
- 16 Vonesë në ekzekutimin e Aktgjykimit
- 17 Konkurse të kurdisura
- 18 Konkurse me diskriminim dhe të ndikuara politikishtë
- 18 Vetëm një u la jashtë 20%-shit
- 19 Ish punëtorët e RTP-së, pa pronëdhe pa paga
- 20 Ish Punëtorët e Ramiz Sadikut dhe mashtrimet me 20%

21 GJETJET

22 REKOMANDIMET

LISTA E SHKURTESAVE

KDI	→ Instituti Demokratik i Kosovës
IP	→ Inspektorati i Punës së Kosovës
KPM	→ Këshilli i Pavarur Mbikqyrës
LP	→ Ligji i Punës
QKUK	→ Qendra Klinike Universitare e Kosovës
ShSKUK	→ Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
TI	→ Transparency International
GjK	→ Gjykata Kushtetuese
GjTh	→ Gjykata Themelore

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2015, Instituti Demokratik i Kosovës përmes Shërbimit për Këshilla ligjore për viktimat, dëshmitarët dhe denoncuesit e korrupsionit, kishte publikuar raportin “Korrupsioni: Cili është tregimi yt?”, në të cilin në mënyrë eksplicite ishin përmbledhur rastet që qytetarët kishin raportuar lidhur me vonesat dhe joefikasitetin e gjykatave në trajtimin e rasteve dhe realizimin e të drejtave të tyre. Gjatë 2016, KDI ka vazhduar të pranojë raste të reja që poashtu shpërfaqnin punën e dobët të gjyqësorit dhe mosekzekutimin e lëndëve. Këto raste u publikuan në raportin e rradhës “Pritja për drejtësi”. Mirëpo jo të gjitha rastet e raportuara në KDI shpiejnë në dyert e gjyqësorit. Në tre vitet e fundit, shërbimi për këshilla ligjore për raportuesit, sinjalizuesit dhe viktimat e korrupsionitka pranuar ankesa nga shumë qytetarë, natyra e të cilave lidhet me të drejtën e punës, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Vetëm gjatë 2018-tës, KDI ja pranuar më shumë se 500 thirrje telefonike, ndërsa ndihmë ligjore ka dhënë tek 60 raste që lidhen me marrëdhënien e punës kryesisht në sektorin privat.



Në vitin 2018 në Kosovë janë regjistruar 20 raste të vdekjeve në vendin e punës si pasojë e mungesës së kushteve dhe sigurisë në punë, por edhe të mbikëqyrjes joefikase të punëdhënësve nga inspektorati i punës.

Sipas statistikave zyrtare, vetëm 28 % e qytetarëve të aftë për punë gëzojnë një vend pune e numri i atyre që janë në kërkim të punës dhe janë të aftë për punë është 686,486 persona. Viti 2018 ka qenë një vit aspak i mirë sa i përket të drejtave të punëtorëve por edhe sigurisë në punë. 20 vdekje në vendin e punës e përcjellën Kosovën nga janari deri në dhjetor, shumica e të cilave nga mungesa e masave të sigurisë në vendin e punës sidomos në sektorin e ndërtimtarisë.¹ Po në këtë vit u shënuan edhe 80 lëndime në punë në të gjithë sektorët.² Në pesë vitet e fundit sipas raporteve të organizatave vendore që merren me sektorin e sigurisë në punë, kanë humbur jetën 99 punëtorë në vende të ndryshme të punës.³

1 Vdekjet e Heshtura, dhjetor 2018 Iniciativa Kosovare për Stabilitet IKS, faqe 2 qasur me 28.01.2019

2 Kosovo 2.0 Viti i përgjakshëm për punëtorët, i qasur me 13.10.2018.

3 Vdekjet e Heshtura, dhjetor 2018 Iniciativa Kosovare për Stabilitet IKS, faqe 6 qasur me 28.01.2019



Në përpjekje për të siguruar një vend pune, qytetarët balafaqohen me shumë padrejtësi dhe shkelje. Rastet e tyre flasin për konkurse të manipuluar, për procedura gjyqësore të pa përfunduara, për ndërrim të vendit të punës kur janë treguar kritik ndaj menaxhmentit, për punë 24 orëshe pa ndërprerë me vazhdim të punës 12 orëshe në ditën e nesërme, mos pagesë të kontributeve penisonale nga punëdhënësi, mos pagesë të pagave deri në 8 muaj, privim nga pushimi vjetor dhe ai mjekësor, mos dhënie e pushimit ditor, mos dhënie e pushimit javor, mospagesë për punën jashtë orarit të rregullt, zvogëlim të pagës pa paralajmërim, dhënie të pagës nën nivelin e pagës minimale etj.

Shumësia e pranimi të rasteve të reja që lidhen me të drejtat e punëtorëve kanë mobilizuar KDI-në edhe këtë vit, që në kuadër të programit të saj për Transparencë dhe Kundër Korrupsion të trajtoj problematikën e "të drejtave të punëtorëve", përfshirë segmentet si pagat, pushimet, procesin e rekrutimit në institucione publike, nepotizmin, korrupsionin, mashtrimin, evazionin fiskal etj. që bëhet në kurriz të punëtorëve dhe qytetarëve me të drejtë pune.

Secili nga rastet e paraqitura në këtë raport shpërfaqë elemente të shkeljeve të të drejtave të punëtorëve në terren, por mbi të gjitha tregon për mungesën e dorës së shtetit në rregullimin dhe zbatimin e ligjshmërisë dhe ndikimin e politikës në konkursat publike. KDI poashtu kavërejtur që qytetarët raportues nuk kanë njohuri të mjaftueshme ku mund t'i paraqesin ankesat për shkeljet që u janë bërë si në vendin e punës, si sektorin privat ashtu edhe atë publik.

Mungesa e zbatueshmërisë së ligjit të punës dhe mbrojtjes e sigurisë në punë si dhe mos respektimi i të drejtave të punëtorëve nga biznesi por edhe institucionet ka bërë që shkeljet të shpeshtohen madje në disa raste punëtorëve vendi i punës ju ka kushtuar edhe me jetë. Në vitin 2018 në Kosovë janë regjistruar 20 raste të vdekjeve në vendin e punës si pasojë e mungesës së kushteve dhe sigurisë në punë, por edhe të mbikëqyrjes joefikase të punëdhënësve nga inspektorati i punës.

Fuqizimi i inspektoratit të punës përmes rritjes së vazhdueshme të numrit të inspektorëve do të ndihmonte në parandalimin e shkeljeve të të drejtave të punëtorëve, fataliteteve në vendin e punës para së gjithash në ndëshkimin e punëdhënësve të cilët shkelin apo neglizhojnë të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Krijimi i sindikatave të punëtorëve në sektorin privat do të krijonte mundësi për dialog të strukturuar midis bizneseve, sindikatave të punëtorëve dhe shtetit në dobi të garantimit dhe avansimit të të drejtave të punëtorëve.




HYRJJE

Sipas definicionit të ILO-së, punë e denjë do të thotë: Dinjitet, barazi, të ardhura financiare të denja dhe kushte të sigurta të punës. Puna e denjë i vendos njerëzit në qendër të zhvillimit, i fuqizon gratë, burrat dhe të rinjtë, iu jep të drejtën për t'u mbrojtur nga eksploatimi dhe iu siguron një të ardhme që është përfshirëse dhe e qëndrueshme.⁴ Kushtetuta e Kosovës në nenin 49 garanton të drejtën e punës dhe zgjedhjes së profesionit por edhe të vendit të punës.⁵ Ligji i punës dhe ai i shërbyesve civil janë dy ligje bazike me të cilat rregullohen çështjet e punës, përfshi të drejtat dhe detyrimet për punëtorët përkatësisht shërbyesit civil. Dallimi në mes të këtyre dy ligjeve është në atë se: ligji i punës rregullon edhe sektorin privat edhe një pjesë të sektorit publik. Ndërsa ligji mbi shërbimin civil rregullon ndër të tjera edhe marrëdhënien e punës në mes shërbyesit civil dhe institucioneve publike të vendit.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2016 në sektorin publik kanë qenë të punësuar 81,629 persona, ndërsa si të punësuar total në Kosovë sipas Vjetarit Statistikor të vitit 2017 ishin 331,761 persona.⁶

Kushtet e punës, trajtimi jo i mirë i punëtorëve, shpëputjet e kontratës pa paralajmërim, zgjatje e orarit të punës, punë deri në 24 orë me vazhdim të punës 12 orëshe në ditën e nesërme, mos pagesë e kontributeve pensionale dhe tatimeve, pagesa me para në dorë, lëndime në punë, punë në kohë festash, konkurse të para-përgatitura (kurdisura) etj. janë mesin e rasteve të pranuar në KDI nga qytetarët përmes linjës telefonike pa pagesë (0800 77777) apo nga takimet e drejtpërdrejta. Ky raport është një përmbledhje e të gjitha këtyre rasteve dhe ka për qëllim të vë në pah mohimin dhe shkeljet e të drejtave të punëtorëve nga punëdhënësit, me theks të punëtorëve në sektorin privat.

Gjatë viteve, raportimet e rasteve dhe ndihma juridike nga KDI ka ndikuar në anulimin e disa konkurseve publike, parandalimin e shumë shkeljeve, zgjedhjen e disa kontesteve dhe në edukimin e punëtorëve për të drejtat e tyre në marrëdhënien e punës.



KUSHTETUTA E KOSOVËS

NË NENIN 49

garanton të drejtën e punës dhe zgjedhjes së profesionit por edhe vendin e punës.



⁴ ILO Organizata Ndërkombëtare e Punës

⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

⁶ Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, faqe 15



euro në muaj bruto, ashtu siç e kishte të përcaktuar edhe me kontratë. Por në bisedë me KDI pala tregoj se as ai e as kolegu i tij nuk mund të shfrytëzojnë pushimin vjetor. Vetë palët kanë deklaruar se nuk guxojnë ta paraqesin rastin në mënyrë të hapur para Inspektoratit të Punës, pasi që rrezikojnë ta humbasin vendin e punës. Sipas tyre çdo kundërshtim apo pyetje në lidhje me kushtet e punës apo pagesat e pagave, mund të vijë deri te paralajmërimi për përjashtim nga puna apo shkëputje të kontratës.

Një ngjarje të njëjtë por vetëm me kompani tjetër të sigurimit fizik RN¹⁰ e ka raportuar edhe BB¹¹ i cili tregon për kushtet e punës dhe shkeljen e të drejtave që i bëhet vazhdimisht atij dhe kolegëve të tij. Edhe kompania e sigurimit fizik RN ka kontrata publike me institucionet komunale dhe qendrore. BB¹² tregon se e ka 3 muaj që as ai e as kolegët e tij nuk kanë pranuar paga në llogaritë e tyre në bankë. Praktika e njëjtë e mbajtjes së 24 orëshit pa ndërprerë është edhe në kompaninë ku punon BB, dhe orari javor prej 12 orësh çdo ditë pune. Edhe BB njëjt si AA, nuk ka marr pushim vjetor e as që mund ta kërkojë atë, pasi që pasojat thotë se janë me largim nga puna.

Rasti tjetër është BK¹³ nga Prishtina, raporton se ka 7 vite që punon në kompani të ndryshme të sigurimit fizik, dhe çdo herë ka vonesa në pagesën e pagës së tij tek secila kompani e sigurimit fizik që ka qenë. BK konfirmon të gjitha deklaratimet e AA dhe BB në lidhje me punën deri në 12 orë dhe fundjavën 24 orëshe.

KDI vitin e kaluar pati raportuar rastet ku punëtorëve të sigurimit u janë shkelur të drejtat e tyre duke mos i paguar kontributet pensionale dhe paga mujore.¹⁴ Se fenomeni i mos pagesë për punëtor të sigurimit fizik është i përhapur dhe vazhdon edhe sot tregon fakti se KDI ka kontaktuar me dy rastet e vitit 2017¹⁵, të cilët kanë ri treguar se përkundër faktit që rastin e kanë raportuar në

10 KDI ka emrin e kompanisë, në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu siç janë pajtuar palët paraprakisht.

11 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu siç janë pajtuar palët paraprakisht.

12 BB ka raportuar me datën 03.05.2018.

13 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu siç janë pajtuar palët paraprakisht. BK rastin e ka raportuar me datën 03.05.2018.

14 Punëtorët që ishin në drejta, nëntor 2017

15 Biseda përmes telefonit me 12.11.2018



1 maj 2018

më shumë se

100 mijë SMS

janë dërguar në numra të ndryshëm në Kosovë, poseduesit e të cilëve janë nga

18 - 65 VJEÇ

ku nga ta është kërkuar që të raportojnë në rast se ju janë shkel të drejtat e tyre në vendin e punës.



Më shumë se

300 telefonata

janë pranuar në ditët e para, edhe në muajt në vijim raportimi i rasteve nga shkeljet e të drejtave të punës ka vazhduar. Shumica e telefonatave kanë kërkuar informata bazike në lidhje me të drejtat e tyre sipas Ligjit të punës meqë ishin nga sektori privat, por që

60 PREJ KËTYRE TELEFONATAVE

janë shëndëruar në raste të hapura për ndihmë juridike nga ana e KDI-së.

mënyrë anonime në Inspektoratin e Punës, asnjë veprim nuk është ndërmarr. Atyre vazhdojnë të ju vonohen pagat dhe të paguhen nën pagën minimale. Lartësia prej 130.00 euro e pagës është nën pagën minimale për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeç e cila sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës të vitit 2011, neni 1 paragrafi 1.2, duhet të jetë minimum 170.00 euro ndërsa për personat nën 35 vjeç ajo mund të jetë 130.00 euro minimalja. Neni 2 i këtij vendimi thotë se kjo pagë mund të negocohet megjithatë nuk mund të jetë më pak se shuma e përcaktuar. Obligimi i zbatimit të këtij vendimi i lihet autoritetit të Inspektoratit të Punës me nenin 3 të vendimit të njëjtë.¹⁶

Një rast tjetër shumë i ngjajshëm me rastet e përmendura më sipër është ai i BT dhe djalit të tij AT,¹⁷ të cilët punojnë në një kompani private. Detyra e tyre e punës është ta rruajnë kompaninë MShC në Komunën e Vitisë, por që ka më shumë se 5 vite që BT nuk i është dhënë pushimi vjetor, ndërsa djalit të tij AT për më shumë se 2 vite. BT thotë se nuk as ai e as djali i tij nuk guxojnë ta përmendin çështjen e pushimit pasi që mbeten pa punë dhe se në mungesë të profesionit do të mbeteshin pa bukë.

7 MUAJ PA PAGË

AS¹⁸, punëtor në fabrikën VI¹⁹ në komunë e Klinës raportoi se ka 7 muaj që nuk ka marr pagë për punën që e ka kryer dhe se zakonisht pagat i ka marr me vonesa. Sipas AS në fabrikën VI ka punëtor që paguhen me para në dorë, pasi që shumë prej tyre janë veteran dhe pronari ka lejuar mundësinë që të paguhen me para në dorë.

Sipas Ligjit për fonde pensionale në Kosovë, Neni 6 paragrafi 1 thotë se çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vetë në Fondin e kursimeve Pensionale. Kurse Neni 6 paragrafi 2 i po të njëjtit ligj thotë se çdo punëdhënës paguan një shumë që është baraz me pesë përqind (5%) të rrogave të përgjithshme të të gjithë punonjësve²⁰.

KDI i ofroi këshilla ligjore, duke i treguar se ku duhet të drejtohet për t'u ankuar për shkeljet e bëra nga punëdhënësi dhe i ndihmoi në përpilimin e ankesës.

TRUSTIN E PAGUAN POR NUK I FIGURON ASKUND

SS²¹, punëtore e pastrimit në Gjimnasin LL²² në Komunën e Prizrenit çdo herë pagën e saj e merr "me para në dorë" e jo përmes xhirollogarisë bankare. Sipas SS çdo herë nga paga e saj ndalet shuma për tatim dhe kontribut pensional, por kur e ka kërkuar raportin nga Trusti Pensional e ka parë se nuk ka asnjë pagesë nga kompania. Pala nuk e dinte nëse kishte kontrat direkte me shkollën apo me ndonjë kompani pastrimi, pasi që sipas SS shpesh i ndryshohen kontratat dhe ajo nuk ju kushton rëndësi.

¹⁶ (Vendimet e mbledhjes se 33 te Qeverisë, fq.4 Neni 1 paragrafi 1.2, Neni 2 dhe Neni 3)

¹⁷ BT dhe AT kanë raportuar rastin e tyre në datën 25.05.2018.

¹⁸ Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. AS rastin e ka raportuar me datën 06.07.2018.

¹⁹ KDI ka emrin e kompanisë, në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht.

²⁰ (Ligji Nr. 04/L-101 për Fonde Pensionale në Kosovë, Neni 6 paragrafi 1 dhe 2)

²¹ Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. SS rastin e ka raportuar me datën 11.05.2018.

²² KDI ka emrin e kompanisë, në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht.

VONESA E GJYKATËS PASOJË PËR PUNËTORIN E LËNDUAR

BH²⁶, për më shumë se një vit kishte punuar në kompanin LG²⁷ kompani e huaj në fushën e ndërtimit, nën kontraktor në ndërtimin e rrugëve në Kosovë. BH tregon se është lënduar në punë dhe lëndimin e tij e ka konstatuar edhe IP dhe rastin e ka dërguar edhe në Degën Gjykatën Themelore në Viti me padi për kompensimin dëmit në punë. Po ashtu për rastin janë hap hetime për kompaninë LG nga Prokuroria Themelore në Ferizaj.

Shqetësimi i palës ishte se kompania që ka punuar ai do ta lë Kosovën pas disa muajsh dhe se Dega e Gjykatës Themelore në Viti nuk ka ndërmarr asnjë veprim procedural që ta përfundoi çështjen.

Në lidhje me kushtet e punës, BH tregon se çdo herë e ka pranuar një pjesë të pagës së tij në bankë dhe një pjesë tjetër me para në dorë. 2.20 euro e ka pas orën për punë në kompani. Sipas tij çdo gjë ka shkuar mirë deri në ditën e lëndimit.

LARGIM NGA PUNA PAS LËNDIMIT

FP²⁸, për më shumë se një vit kishte punuar në kompanin J.²⁹ në degën e saj Pejë si kuzhinierë. Disa ditë para vitit 2018 derisa ishte në punë i rrëshqet këmba dhe lëndohet në punë. Pasi që ka qenë e lënduar mjeku i kishte rekomanduar pushim mjekësor për disa ditë.

FP nuk kishte përfillur këshillat e mjekut dhe vetëm që të mos mbetej mbrapa me punë, pas dy ditësh ishte kthyer në vendin e saj të punës. Fillimisht ishte penguar që të hyjë në punë, e më pas kishte kontaktuar me menaxherin e pikës dhe ai i kishte shpjeguar se kontrata e saj ishte shkëputur. Ajo ishte munduar ta qartësoj situatën por pa sukses. Me datën 12 janar të vitit 2018 e kishte paraqitur rastin në Inspektoratin e Punës.

Disa ditë më vonë e njëjta kishte pranuar një telefonatë nga menaxheri i J. ku i kishte ofruar vendin e punës me kusht që të largonte rastin nga Inspektorati i Punës. Mirëpo ajo nuk e kishte larguar kërkesën e saj nga IP mirëpo kishin kaluar më shumë se 5 muaj që e njëjta nuk kishte marr përgjigje nga IP.

Në kohën e raportimit, palës i'u rekomandua që të paraqitet prap te zyra e IP në Pejë dhe në rast se nuk ka vendim të lajmërohet prap. KDI ka tentuar edhe disa herë që ta kontaktoj palën por pa sukses.

PUSHIMI I DETYRUAR PA PAGESË

Punëtori në ndërtimtari të rrugëve MB³⁰, nga komuna e Ferizajt tregon se për disa vite ka punuar në kompaninë BE.³¹, mirëpo në muajin shtator të vitit 2018 menaxheri i tij e kishte nxjerr në pushim të detyruar pa e paguar këtë të fundit.

Sipas MB menaxheri dhe persona të afërt me të e kanë realizuar një skemë mashtrimi, ku nxjerrin në pushim punëtorët aktual dhe për shumën prej 300 – 400 euro ata punësojnë në ato pozita njerëz të tjerë që kanë nevojë për punë.

26 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. BH rastin e ka raportuar me datën 18.12.2018.

27 KDI ka emrin e kompanisë, në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht.

28 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. FP rastin e ka raportuar me datën 23.05.2018.

29 KDI ka emrin e kompanisë, në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht.

30 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. MB rastin e ka raportuar me datën 27.09.2018.

31 KDI ka emrin e kompanisë, në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht.

MB nuk kishte njohuri mbi të drejtat e tij dhe rastësisht kishte kuptuar për KDI-në dhe këshillat ligjore pa pagesë prandaj edhe ishte drejtuar. KDI rekomandoi palën që të drejtohet tek Inspektorati i Punës për ta treguar kontratën e tij të punës dhe mos përmbushjen e saj nga menaxhmenti i kompanisë.

MOS LEJIM I NDRYSHIMIT TË VENDIT TË PUNËS

ShD³², nga Peja për më shumë se 21 vite po i shërben sistemit arsimor në këtë komunë. Vitin 2017 pasi që një koleg i saj u pensionua në një shkollë të qytetit iu hap mundësia që të transferohej aty pasi që për 21 vite kishte udhëtuar për në fshat ku edhe zhvillonte procesin mësimor. ShD kohë pas kohe kishte plotësuar orët e normës në shkollën që donte të transferohej, kjo pasi që për vite me rradhë nuk kishte arritur ta plotësonte normën vetëm në një shkollë, çdo herë i është dashur të marr orët shtesë në një shkollë tjetër. Madje ShD në disa raste kishte mbajtur edhe lëndë të tjera të cilat nuk lidheshin me thirrjen e saj profesionale.

Hapja e mundësisë në shkollën në qytet e kishte shtyrë ShD që t'i drejtohet Drejtoratit të Arsimit në Pejë për transferim në atë shkollë, mirëpo kërkesa e saj nuk kishte marrë përgjigje nga DKA e Pejës. Pala kishte pritur përgjigje sipas afateve ligjore dhe më pas kishte dërguar edhe një shkresë tjetër në drejtim të komunës, por edhe ajo pa suksese. Ajo ishte detyruar që ta njoftonte Inspektoratin e Arsimit për të evituar parregullësin që pretendonte se i bëhej. Përgjigjja që kishte marr nga ky inspektorat ishte zgënjyese për ShD, por kërkesat për institucione të tjera nuk ndaluan. ShD i'u drejtua Inspektoratit të Punës për të drejtën e saj por asnjë institucion nuk ja dha të drejtën. ShD në kohën e aplikimit ishte me e kualifikuar se kandidatja e pranuar. Pasi që rastit të saj nuk ju gjet zgjidhje,

ajo ju drejtua Gjykatës Themelore në Pejë, ku është duke pritur përgjigje nga Gjykata, në lidhje me kërkesën për transferim në shkollën në qytet. Pala është duke pritur që Gjykata të zhvilloi procedurat e përshpejtuara meqë rasti i saj ka të bëjë me çështje të punës.

REDUKTIM ORËSH PËR INTERESA PERSONALE

HH³³, nga Mitrovica ka më shumë se 23 vjet që punon në sistemin arsimor në këtë komunë. Puna e saj kryesore ka qenë ligjërimi i lëndëve të natyrave shoqërore, për çka edhe ka thirrje universitare. Në vitin 2015 i kishin filluar problemet me Drejtorin e Arsimit në Komunën e Mitrovicës, atëherë kur kjo e fundit i'a kishte përgjysmuar orët nga norma e saj nga 20 orë kishte rënë në vetëm 10 orë në javë për të mbajtur.

Në vendin e saj me vendim të DKA-së dhe me bekimin e drejtorit të shkollës ishte punësuar MU. Ajo sipas palës kishte lidhje farefisnore me një nga drejtorët e shkollave në Mitrovicë dhe ishte familje e afërt me një prokuror të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë. Sipas HH kjo po i pamundësonte në realizimin e të drejtës së saj kudo që e kërkonte.

KDI i rekomandoi që të njoftohet Inspektorati i Punës për reduktimin e orëve dhe për trajtimin jo i barabartë që po i bëhet asaj nga DKA në Mitrovicë. Po ashtu këshillohet që të përgaditë dhe padinë për dorëzim në Gjykatë nëse çështja nuk merr epilog në vendimtar.

KËRCËNIM NË VENDIN E PUNËS

ML³⁴, është arsimtar në një nga shkollat e mesme të Prishtinës, ai bashkë me shumë koleg të tij çdo ditë

32 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. ShD rastin e ka raportuar me datën 20.06.2018.

33 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. HH rastin e ka raportuar me datën 16.05.2018.

34 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. ML rastin e ka raportuar

përballen me shumë vështirësi në procesin mësimor. Por ML ka edhe një penges tjetër, shpesh atë në kryerjen e punëve të tij e pengon drejtori i shkollës dhe zëvendësi i tij. Kërcënimet me largim nga vendi i punës, marrja e ditarit, mos lënie e zhvillimit të orëve, janë disa nga problemet me të cilat ML ballafaqohet gati çdo ditë.

Sipas tij, drejtori, zëvendësi i tij dhe disa arsimtar janë të lidhur në mes vete dhe shfrytëzojnë shkollën për përfitime personale. ML tregon se shkolla e tyre mban mësim klasor (mësimi i natës) ku ju mundësohet personave që nuk e kanë përfunduar shkollimin e mesëm që ta përfundojnë atë. ML thotë se provimet të cilat mbahen nga arsimtarët e shkollës paguhen nga nxënësit, por jo të gjitha parat përfundojnë në xhepat e mësimeve, një pjesë e tyre merret nga drejtori apo persona të tjerë të lidhur me të.

Një problem tjetër pse ML ka marr kërcënime të vazhdueshme në mënyrën se si i noton nxënësit gjatë procesit mësimor, madje shpesh drejtorja i ka ftuar inxhinierët në monitorimin e ML në procesin mësimor. Mbyllja e notave në ditarët për nxënësit nga ai është përcjell çdo herë edhe me ndërhyrjen mbi notimin e tij dhe me falsifikim notash nga drejtori, zëvendësi apo persona të afërt me ta.

Shqetësimi më i madh i ML ishte provokimi për mos vazhdimin e kontratës për vitet në vijim. Por, fatmirësisht ML në nëntorin e 2018 morri vendimin për vazhdimin e kontratës.

Me ndihmën e KDI, ML i është drejtuar me kallëzim penal Prokurorisë Themelore në Prishtinë, duke kërkuar hetimin për veprat penale që në vazhdimësi ka në kryer drejtori, zëvendësi i tij dhe persona të tjerë që janë të lidhur me ta. KDI së bashku me ML do të ndjekin nga afër procesin e hetimit dhe në rast të ngritjes së akuzave, procesin e gjyqimit të personave përgjegjës.

MOS AVANCIM NË PUNË PA ARSYE

Sinjalizuesi PS³⁵, është punëtorë në shërbimin e Zjerrëfikësve të Prishtinës. Ai është në mesin e shumë punëtorëve që nuk është mundësuar që të ngriten në detyrë përkundër faktit se ai ka kualifikimin e duhur shkollor dhe se shumë pozita udhëheqëse janë të lira në shërbim. Sipas sinjalizuesit udhëheqësi kryesor i ka refuzuar kërkesën për gradim fillimisht me arsyetimin e mungesës së shkollimit adekuat e më pas nuk i kishte kthyer përgjigje në kërkesat e tij.

Sinjalizuesi tregon se ai dhe kolegët e tij në pozita të njëjta, realisht kryejnë detyrat e udhëheqësve të ekipeve të zjerrëfikësve dhe shumë shpesh hasin në vështirësi gjatë kryerjes së punës.

Sinjalizimi i tij ka të bëjë edhe me keqpërdorimet që bëhen nga individ të caktuar në karburante, në goma dhe në rregullimin e autoboteve në rastet e prishjeve.

Preferenca për njëri të caktuar ka bërë që edhe në rastet kur nuk kalohen testet e aftësive të zjerrëfikësit, për ta të mbyllen sytë dhe çdo gjë të rregullohet. Po ashtu personat të njëjtë tash me vendimin e komandantit të përgjithshëm kanë shkuar për trajnim në Akademinë e Policisë në Vushtrri, çka ka lënë shërbimin pa 13 persona. Për pasoj punëtorët aktual do të detyrohen të punojnë edhe shpesh të ju cenohet e drejta për tu mos graduar.

VONESË NË EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMIT

TH³⁶, gjithë jetën e tij në komunën e Gjilanit ja kushtoi arsimi dhe në vitin e kaluar ai doli në pension të moshës.

me datën 06.09.2018.

35 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. PS rastin e ka raportuar me datën 13.06.2018.

36 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. TH rastin e ka raportuar me datën 03.05.2018.

Në kohën e daljes në pension, TH kupton që Ligji i Punës lejon që personat që dalin në pension të marrin edhe 3 paga shtesë. Mirëpo kjo e drejtë nuk i ishte plotësuar nga Drejtoria e Arsimit në Gjilan, dhe TH ishte detyruar që ta paditë në Gjykatën Themelore, Komunën për mos kompensimin e 3 pagave shtesë.

Gjykata me një vendim i kishte njohur të drejtën palës TH për 3 pagat shtesë pas daljes në pension. Pas plotëfuqishmërisë së vendimit për 3 pagat, TH ende nuk ka arritur ta përfundojë këtë çështje dhe të marrë pagat e njohura nga Gjykata, rrjedhimisht vendimin e pa implementuar nga Komuna e Gjilanit e ka kthyer prap në gjykatë, tash me kërkesë të re për përmbartimin e vendimit gjyqësor.

TH ankohet se ka shumë kohë që nuk po përmbartohet çështja e tij, kështu që kërkojë ndihmën e KDI në lidhje me atë se a mund lënda të përmbartohet nga përmbartuesit privat. Pas analizimit të ligjit të përmbartimit del se për çështjet e punës përmbartimi është kompetencë ekskluzive e gjykatës. Andaj TH duhet të pres derisa Gjykata të vendosë në përmbartimin e vendimit të saj, dhe e ndihmojë palën me shkrimin e një urgjence për Gjykatë.

KONKURSE TË KURDISURA

AN³⁷, tregon se në vitin 2018 kishte parë në media një konkurs të ndërmarrjes publike për regjionin e Ferizajt përfshi edhe komunën e Kaçanikut, prej nga edhe vjen ai. Meqë plotësonte kriteret e punësimit, AN kishte paraqitur dokumentet për të filluar procedurat e punësimit.

Ai ishte ftuar dhe kishte marrë pjesë në testimet e para, por që nga fillimi kishte kuptuar se konkursi është i manipuluar, meqë aplikantët tregonin se kush do të pranohet në punë në secilën nga 17 pozitat. Dhe ashtu doli, edhe për pozitën e tij ishte pranuar personi që parakisht ishte përfolur se do të pranohet.

AN ishte ankuar në vendimin mbi pranimin e punëtorëve,

por bordi i ndërmarrjes e kishte refuzuar ankesën e tij. Një ankesë shtesë e kishte bërë të bordi në lidhje me konkursin, ai kishte vërejtur se konkursi është i shkruar vetëm në gjuhën shqipe dhe nuk ka afat të përcaktuar të punës për pozita. Ankesat për këto çështje i kishte drejtuar në bord dhe më pas në inspektoratin e punës. Por të gjitha i ishin refuzuar.

Pala së fundmi do të paraqes ankesë për vendimin e inspektoratit në Gjykatën Themelore në Prishtinë departamenti Administrativ, për hapjen e kontestit me Inspektoratin e Punës.



Preferenca për njerëz të caktuar ka bërë që edhe në rastet kur nuk kalohen testet e aftësive të zjarrëfikësit, për ta të mbyllen sytë dhe çdo gjë të rregullohet. Po ashtu personat të njëjtë tash me vendimin e komandantit të përgjithshëm kanë shkuar për trajnim në Akademinë e Policisë në Vushtrri, çka ka lënë shërbimin pa 13 persona. Për pasojë punëtorët aktual do të detyrohen të punojnë edhe shpesh të ju cenohet e drejta për të mos u graduar.

37 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. AN rastin e ka raportuar me datën 23.11.2018.



KONKURSE ME DISKRIMINIM DHE TË NDIKUARA POLITIKISHT

Një nga ministrinë kryesore në Qeverinë e Kosovës në fillimin e vitit 2018 kishte hap konkurs për punim në punë të një zyrtari. FH³⁸ nga Prishtina kishte aplikuar dhe i ishte nënshtruar testimit me gojë dhe me shkrim, por nuk ishte pranuar në punë edhe pse sipas saj ishte më e mira. Në punë ishte pranuar AZ që ishte aktiviste e subjektit politik që qeverisë në atë ministri. FH kishte paraqitur ankesë në burime njerëzore, por që ankesa e saj ishte refuzuar pas ndonjë sqarim.

FH nuk e kishte dërguar çështjen në instanca tjera pasi që nuk kishte pas informata se mund ta bënte një gjë të tillë.

Pak muaj më vonë Ministria kishte hapur një konkurs tjetër për një pozitë të re, dhe FH menjëherë kishte aplikuar. Pas testimit me shkrim dhe gojë po priste rezultatin pozitiv, megjë kishte parë që konkurrenca nuk kishte qenë më e mirë se ajo. Pas disa ditë pritje, Ministria kishte shpall anulimin e konkursit.

Edhe në rastet e më hershme KDI ka dëgjuar nga palët praktika të tilla, kur nuk arrihet dakordimi i palëve për një person politik, atëherë komisioni e anulon konkursin për ta rishpallur prap me kritere të përshtatura për persona të caktuar.

Rast i ngjajshëm është edhe me arsimtaren AV³⁹ që në tetor 2018 kishte aplikuar për një pozitë për lëndë profesionale në një shkollë të mesme në komunën e Drenasit.

Ajo pretendon që ka plotësuar të gjitha kushtet dhe se shkollimi i saj ishte më i lartë se e të gjithë kandidatëve

të tjerë, por që ajo në fund sipas rezultateve nuk e kishte fituar punën. AV thotë se punën e fitoi një person tjetër që mund të ketë lidhje me politikën. Dhe se në kohën e konkursit personi që u pranua në vendin e punës ishte duke punuar me kontratë të përkohëshme të punës.

KDI i ofroi ndihmën juridike në përpilimin e ankesës kundër vendimit të komisionit për përzgjedhjen e mësimdhënësve. Ankesa i'u drejtua Komisionit për ankesa në Komunën e Drenasit.

Shklejet në rastin e saj ishin të shumta, nga lënda e trajtuar kuptuam se Drejtoria e Arsimit nuk kishte nxjerr rezultatet e plotë me poentim por vetëm emrat e fituesve. Fakti që kishte punuar me kontratë të përkohëshme dhe më pas ishte pranuar në punë duke ju njohur si përvojë pune ajo kohë, u konsiderua nga ne si diskriminim në punë, e ndaluar me nenin 5 të Ligjit të punës. Kërkesa e drejtuar komisionit të ankesave ishte që të anulohet konkursi dhe të bëhet shpallja e re por edhe t'i ofrohet mundësi e barabart të gjithëve.

Komisioni për Ankesa në dhjetor kishte marr vendim që ta pranoj ankesën e AV dhe konkursin për pozitën e saj ta anuloi.

VETËM NJË U LA JASHTË 20%-SHIT

Si inxhinier i bujqësisë shumë kohë para luftës ishte punësuar në një nga ndërmarrjet shoqërore të asaj kohë në komunën e Drenasit, AB⁴⁰ nga Drenasi pas përfundimit

38 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. FH rastin e ka raportuar me datën 24.05.2018.

39 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. AV rastin e ka raportuar me datën 10.10.2018.

40 Të gjitha emrat e punëtorëve në raport do të gërmëzohen dhe identiteti i tyre do të mbrohet, ashtu sic janë pajtuar palët paraprakisht. AB rastin e ka raportuar me datën 11.04.2018.



të luftës në 1999 ishte kthyer në punë, ku së bashku me gjithë punëtorët e tjerë kishin punuar deri në vitin 2004. Më heret në 2003 kishte pas një problem me drejtorin udhëheqës të ndërmarrjes, e gjithë kjo pasi që AB kishte refuzuar që ta nënshkruante një ndryshim të pronës në mes ndërmarrjes dhe një personi privat.

Drejtori e kishte paralajmëruar se për këtë veprim do të pësonte, dhe kështu i doli. Kur ndërmarrja doli në privatizim, të vetmit që nuk i doli emri për marrjen e 20% ishte AB.

Menjëherë rastin e tij e paraqiti në ish AKM (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit) por pa ndonjë sukses, edhe pse kishte të gjitha provat se kishte qenë në listën e pagave para dhe pas luftës.

shëm nga RTK-ja dhe televizionet tjera private, pa asnjë kompensim për punëtorët apo RTP-në. Sipas M. në vitin 2000 sindikata kishte arritur ta regjistronte kompaninë RTP si entitet juridik dhe më pas në 2001 kishte paraqitur padi në Gjykatë për kthimin e pronave të saj.

Kryesindikalisti tregon edhe për humbjen apo tjetërsimin e disa pronave milionëshe në qendër të Prishtinës, të cilat me vendim shtetëror në vitet e 80-ta i ishin ndarë RTP-së për ndërtimin e hapësirave të reja për TV dhe Radio. Ai tregon se gjithë Kosovën RTP ka prona dhe asnjërin nga to nuk e ka në posedim.

Lënda që mban numrin C.nr:601/01 nuk ka marr epilog përfundimtar dhe shumica e punëtorëve të RTP-së presin kompensimin për vitet e humbura të punës.

Së fundmi AB lëndën e tij e kishte dërguar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga e cila po kërkon drejtësi.


KDI ka ofruar mundësinë e bashkëpunimit dhe ndihmës juridike falas për sindikatën e punëtorëve që të realizojnë të drejtat e tyre.



ISH PUNËTORËT E RTP-SË, PA PRONË DHE PA PAGA

LM është udhëheqësi i sindikatës së ish punëtorëve të Radio Televizionit të Prishtinës, që në kohën e mbylljes numronëte afërsisht 900 punëtor. Shumica e punëtorëve kanë mbetur pa punë, pasi që me themelimin e Radio Televizionit të Kosovës RTK-së, nuk ju është mundësuar që të kthehen në punë dhe nuk e ka deklaruar si pasardhëse të ish RTP-së.

Por sipas udhëheqësit sindikal Mjeku, të gjitha pronat dhe arkivat e ish RTP-së janë në shfrytëzim të vazhdue-



Së bashku me grupin e punëtorëve përgjatë vitit 2018 janë organizuar tri protesta në kërkim të hetimit për

humbjen e 20% 450 PUNËTORË



ISH PUNËTORËT E RAMIZ SADIKUT DHE MASHTRIMET ME 20%

Rasti tjetër është ai i ndërmarrjes shoqërore Ramiz Sadiku e cila është privatizuar nga ish Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit AKM, ndërsa pas privatizimit të kësaj ndërmarrje, një pjesë e punëtorëve mbeti jashtë listës së pagesave të 20%.

Për rastin e njëjtë KDI ka raportuar edhe në raportin e kaluar mbi të drejtat e punëtorëve.

Sipas palëve të paraqitura tek KDI, ata nuk kanë qenë të informuar për procesin e privatizimit të ndërmarrjes dhe rrjedhimisht kanë humbur të drejtën për të kërkuar edhe 20%. Palët pretendojnë se janë një grup prej 450 personash të cilët ju është mohuar e drejta për 20%.

Së bashku me grupin e punëtorëve përgjatë vitit 2018 janë organizuar tri protesta në kërkim të hetimit për humbjen e 20% nga këta 450 punëtorë. Protestat u realizuan tek AKP (Agjencioni Kosovar i Privatizimit) dhe tek Prokuroria e Shtetit.

Në takimet në mes udhëheqësve të grupit të punëtorëve dhe zyrtarëve të AKP por edhe të Prokurorisë së Shtetit, çdo herë i'u është premtuar që do të merren masat dhe do të hetohet çështja e tyre. por në realitet ish punëtorët e Ramiz Sadikut vazhdojnë të mos përfitojnë 20% dhe hetimet për lëndën e tyre vazhdojnë të mos zhvillohen.



GJETJET

Të drejtat e punëtorëve përveç që janë të mbrojtura me Kushtetutë dhe ligje në Kosovë, ato mbrohen edhe nga konventat të ndryshme ndërkombëtare, por shkelja e këtyre të drejtave në Kosovë është e vazhdueshme. Kjo mbështetet edhe nga 60 rastet e raportuara vetëm në vitin 2018, e raportime më interesante u shtjelluan më lartë.

Qytetarët që kanë raportuar për shkeljet e të drejtave nga marrëdhënia e punës, në përgjithësi nuk kanë informata mbi të drejtat e tyre si punëmarrës.

Shkeljet e të drejtave të punëtorëve janë të përhapura si në sektorin publik edhe në atë privat, pa përjashtim. Natyra e shkeljeve në sektorin publik lidhet me konkurset publike, përkatësisht shfrytëzimin e tyre për punësim mbi baza partiake dhe me nepotizëm. Në sektorin privat, shumica e shkeljeve lidhen me moszbatimin e ligjit të punës dhe akteve tjera ligjore që rregullojnë çështjen e pagesës, orarin e punës, punën jashtë orarit, pagën minimale, pagesën e kontributeve pensionale etj.

Përkundër raportimeve është pasqyre reale e tregimeve nga vet personat që pretendojnë se ju janë shkelur të drejtat. Në anën tjetër nga rëfimi i tyre kupton edhe anën e mos përfilljes nga institucionet shtetërore sidomos në rastet kur pritet vendimarrje e shpejtë për të eliminuar pasojat për punëtorin apo punëdhënësin. Mos trajtimi i rasteve me efikasitet dhe shpejtësi prodhon pasoja si për punëtorin ashtu edhe për punëdhënësin.

 E përbashkëta e sektorit privat nga raportimi është se shkeljet e të drejtave vazhdojnë.

 Të gjithë ata që kanë raportuar nga sektori privat, nuk i raportojnë rastet në institucione nga frika e humbjes së vendit të punës edhe nëse kanë kontrata valide të punës.

 Shumë nga punëtorët, sidomos të sektorit privat, nuk kanë njohuri se cilat institucione janë përgjegjëse për të mbrojtur të drejtat e tyre.

 Disa raportime nga sektori privat kanë qenë treguar se punëtorëve nuk ju janë paguar pagat me rregull dhe në kohë, nuk ju janë lejuar pushimet ditore, javore dhe vjetore e që janë shkeljet shtesë që po konstatohen çdo herë.

 Këto kompani private kanë arritur të fitojnë edhe tender publik dhe të kryejnë shërbimin me këta punëtorë të cilëve ju shkelen të drejtat e tyre. Mos pagesa e kontributeve pensionale apo trustit është një formë tjetër shpesh e raportuar në KDI.

 Përkundër detyrimeve ligjore disa kompani nga sektori privat arrin që punëtorëve të tyre të mos ju paguajnë kontributet pensionale kjo pasi që pagat kryhen me para në dorë.

 Punëtorët e nga sektori privat tregojnë për mungesën e vizitave nga Inspektoriati i Punës apo mos përgjigje të Inspektoratit të Punës në rastet kur ata paraqiten si anonim.

 Formë e shpesht e shkeljeve gjatë procedurave të punësimit është fiksimi i konkurseve për të favorizuar persona të lidhur me subjekte politike që janë në pushtet.

 Shteti përmes prokurimit publik po lejon shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të punëtorëve, sidomos në rastet kur merren shërbime të caktuara nga këto institucione.

REKOMANDIMET

-  Inspektorati i Punës duhet të vizitoi në terren këto kompani të sigurimit fizik dhe të shoh për kushtet e punës së punëtorëve.
-  Inspektorati i Punës duhet që në bashkëpunim të ngusht dhe inspektim të përbashkët me Administratën Tatimore të Kosovës dhe Trustin Pensional të shoh nëse janë paguar tatimet dhe kontribuet nga këto kompanitë private.
-  Inspektorati i Punës, në rastin kur gjen shkelje tek kompanitë që kanë tender publik duhet me automatizëm të njoftoj autoritet kontraktuese në lidhje me shkeljet që ju bëhen punëtorëve.
-  Inspektorati i Punës duhet që të marr iniciativën që të ju dërgoi të gjitha autoriteteve kontraktuese obligimet ligjore që kanë për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve në punë në rastet kur kontraktuesit i shkelin ato të drejta.
-  Të gjitha autoritetet kontraktuese në Kosovë duhet që të kenë parasysh të drejtat e punëtorëve në kompaninë e kontraktuar. Kujdes të shtuar duhet të ketë tek pagat e punëtorëve.
-  Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës/ Ministria e Punës dhe Mirëqenjës Sociale përmes buxhetit të parasheh rritjen e vazhdueshme të numrit të Inspektorëve të Punës;
-  Inspektorati i Punës të rrit numrin e inspektimeve në terren;
-  Inspektorati i Punës të vazhdoj me kampanja vetdijësuese mbi të drejtat e punëtorëve dhe shkeljet e mundëshme për punëdhënës dhe punëtor;
-  Inspektorati i Punës duhet të ofroi mundësi që punëtorët të paraqesin ankesat e tyre në mënyrë anonime dhe ankesat e njëjta të merren parasysh.
-  Inspektorati i Punës duhet të rrit nivelin e transparencës duke bërë publike në ueb faqe të gjitha vendimet që i merr;
-  Këshilli i Pavarur Mbikqyrës dhe Inspektorati i Punës duhet të unifikojnë vendimet e tyre për çështjet që ato trajtojnë në rastet e njëjta;
-  Këshilli i Pavarur Mbikqyrës duhet të ofëroj mundësi që punëtorët e shërbimit civil të kenë mundësi që paraqesin ankesat e tyre jo vetëm në qendrën në Prishtinë por edhe në regjionet më të mëdha;
-  Qeveria e Kosovës së bashku me Sindikatat e punëtorëve por edhe sektorin privat duhet ta përpilojnë kontratën kolektive dhe ta nënshkruajnë atë;
-  Ministria e Punës dhe Mirëqenjës Sociale duhet të krijoj mekanizmat që detyrojnë edhe kompanitë private të kenë organe sindikale.
-  Gjykatat duhet të përmbahen afateve ligjore dhe çështjet e punës duhet ti trajtojnë me efikasitet dhe prioritet;

|||||

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

ISBN

|||||

THIRR

**0800
77 777**

RAPORTO KORRUPSIONIN

**KORRUPSIONI
PAMUNDËSOHET
KUR RAPORTOHET**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni
www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare të:

